

MENAXHIMI I EMERGJENCEVE

Përshkrimi i kursit

Ujësjetllësata kanë përgjegjësi ligjore të sigurojnë furnizim me ujë të sigurt për konsumatorët e tyre edhe në rast emergjencash. Shoqëritë të cilat parapërgatiten mund t'i përballojnë në mënyrë më efektive emergjencat dhe të riaftësohen më shpejt pas tyre. Ky kurs trajnimi ka si qëllim ndërgjegjësimin për rolin e planifikimit në përbashkëtimin e emergjencave dhe zvogëlimin e pasojave të tyre.

Kursi do të trajtojë çështje të cilat kanë të bëjnë me shkaqet e emergjencave në shoqëritë ujësjetllës kanalizime, vlerësimin e cënueshmërisë së komponentëve të sistemit nga emergjencat dhe fatkeqësitë natyrore, masat zbutëse për komponentët e sistemit si dhe hartimin e një plani gatishmërie (plani emergjencash).



Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ta trajtuar me efektivitet ciklin e plotë të menaxhimit të emergjencave.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjetllës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për menaxherët, inxhinierët, teknikët si dhe stafin e operim mirëmbajtjes.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni rëndësinë e planifikimit në rast emergjencash;
- Përcaktoni efektet e rreziqeve të mundshme si pasojë e emergjencave për çdo komponent të sistemit;
- Identifikoni komponentët më kritik të sistemit;
- Identifikoni masat zbutëse për çdo kategori të sistemit;
- Hartoni masa për zbutjen e pasojave të emergjencave në çdo kategori të komponentëve të sistemit;
- Kuptoni rëndësinë e planit të gatishmërisë për rastet e emergjencave;
- Njihni parimet bazë të një plani gatishmërie;
- Analizoni emergjencat dhe shkallën e tyre;
- Vlerësoni planin e ndërhyrjes dhe gatishmërisë ndaj emergjencave.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në PowerPoint, të ndërthurura me diskutime. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi, do të pajisen me Manualin e Trajnimit "Menaxhimi i Emergjencave". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.